

I POL

BALKAN POLICY INSTITUTE
INSTITUTI BALLKANIK I POLITIKAVE
BALKANSKI INSTITUT POLITIKA
BALKAN POLITIKA ENSTITÛSÛ

EULEX: DUKE KËRKUAR IDENTITETIN

27/12/2009
Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

EULEX: Hyrje.....	4
Policia	6
Drejtësia	6
Doganat	7
Strategjia e EULEX-it.....	8
Arritjet e EULEX-it gjatë këtij viti të veprimit	9
Qytetarët dhe EULEX-i	12
Dështimet kryesore të EULEX-it gjatë këtij viti.....	14
Rekomandime.....	18
Për Qeverinë dhe EULEX-in.....	18
Për BE-në dhe PSBE-në	18
Rreth IPOL-it	19

Akronime

BE, Bashkimi Evropian.

EULEX, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

PSBE, Përfaqësuesi Special i BE-së.

ICO, Zyra Civile Ndërkombëtare

PK, Policia e Kosovës

Përmbledhje ekzekutive

Raporti ndahet në disa pjesë, pjesa e parë kryesisht ka të bëjë me misionin e EULEX në Kosovë, qëllimet e këtij misioni dhe sferat në të cilat ky mision është përqendruar. Raporti vazhdon me një pjesë të veçantë e cila i kushtohet arritjeve që ka pasur EULEX në Kosovë, në dogana, polici dhe gjyqësi. Një pjesë i kushtohet perceptimeve të qytetarëve për EULEX-in. Një kapitull i kushtohet dështimeve të këtij misioni dhe mospërmbushjes së qëllimeve për të cilat është prezent në Kosovë. Raporti përfundon me një listë të rekomandimeve për EULEX-in, Qeverinë e Kosovës, BE-në dhe Përfaqësuesin Special të BE-së (PSBE).

Pjesa në të cilën është fokusuar ky raport ka të bëjë më problemet që e kanë përcjellur dhe dështimet e këtij misioni. Bazuar në qëllimet për të cilat ka rrdhur EULEX në Kosovë, mund të themi se ka pasur vetëm realizimin të pjesës së tyre. Dhe ky mision vazhdimisht ka pasur probleme që kanë ardhur si pasojë e mos koordinimit të Komunitetit Ndërkombëtar.

Plani gjashtë pikësh i Ban Ki Moon ka mundësuar operacionalizimin e EULEX-it, mirëpo ka qenë plan kontrovers që nuk është përkrahur nga shoqëria kosovare. Si dështimet kryesore janë cekur: Protokollit për Bashkëpunim policor me Serbinë dhe Rasti Bllaca. Pikërisht nënshkrimi i Protokollit për Bashkëpunim policor me Serbinë bëri që edhe kënaqshmëria e qytetarëve për punën e EULEX-it të bie, përderisa që nga Maj 2008 deri në Gusht 2009 kishte shënuar rritje graduale. Gjithashtu ndër dështimet teknike të këtij misioni në Kosovë u përmenden: Mosfunksionimi i gjyqësorit, Pikat doganore 1 dhe 31, mospërputhja e strategjive, moskoordinimi dhe, mospërkushtimi ndaj misionit.

EULEX: Hyrje

Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) është misioni më i madh civil i nisur ndonjëherë nën Politikën Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP). Qëllimi kryesorë është që të ndihmojë dhe të mbështesë autoritetet e Kosovës të sundimit të ligjit, në veçanti në sferën e policisë, gjyqësisë dhe doganave¹. Sipas shefit të misionit, Yves de Kermabon misioni në Kosovë nuk është për të qeverisur apo të mbajë rregull, por për të mbështetur pronësinë vendore. Është një mision teknik i cili do të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë kurse do të mbajë edhe një numër të kufizuar të fuqive ekzekutive², dhe EULEX-i punon sipas Rezolutës 1244, dhe ka një zinxhir të unifikuar komandues në Bruksel.

EULEX-i ka për qëllim që të ndihmojë autoritetet gjyqësore dhe institucionet e zbatimit të ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies sipas standardeve evropiane. Ai do të zhvillojë më tej forcimin e një sistemi të pavarur dhe shumë-etnik të drejtësisë dhe policisë shumë-etnike dhe shërbimin doganor, duke siguruar që këto institucione janë të lira nga ndërhyrja politike dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane për të cilat e Kosova ka nevojë shumë. Baza ligjore për misionin është krijuar në një rezolutë të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të Evropës më 4 shkurt 2008.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës misioni për sundim të ligjit EULEX është ftuar nga institucionet e Kosovës për monitorim dhe asistencë në fushën e sundimit të ligjit. Në fillim ky mision u ballafaqua me shumë probleme, paqartësia lidhur me mandatin dhe kompetencat e tij ishte njëra nga ato. Për të realizuar misionin e tij EULEX-i në Kosovë është fokusuar në 3 fusha kryesore:

Polici – EULEX, krahas Policisë së Kosovës (PK), ka policinë e tij e cila vepron si institucion paralel por që në praktikë shërben më shumë për sigurimin e personelit të EULEX-it. Të rralla janë rastet kur policia e EULEX-it ka rol aktiv krahas PK.

Drejtësi – EULEX ka një numër prokurorësh dhe gjyqtarësh të instaluar në Kosovë. Këtu EULEX-i asiston me prokurorë dhe gjyqtarë evropianë dhe ndërkombëtarë duke u marrë me raste të rënda të cilat sistemi i drejtësisë së Kosovës nuk është i aftë apo nuk ka kapacitete për t'i ekzekutuar. Në këtë komponent bartja e kompetencave dhe informacionit nga strukturat e UNMIK-ut në EULEX kanë qenë të stërzgjatura. Dhe kjo rezultoi në rritjen e skepticizmit të qytetarëve të Kosovës ndaj EULEX-it.

Dogana - Për sa i përket doganave misioni i EULEX-it luan një rol më aktiv në veriun e Kosovës ku pikat doganore pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishin djegur nga serbet e veriut. Këto pika doganore janë në administrim të plotë të EULEX-it.

Në gjashtë mujorin e parë të vendosjes së tij EULEX-i është përcjellë me shumë vështirësi duke filluar nga mangësia e stafit deri te paqartësitë rreth mandatit dhe shtrirjes. Qëndrimi i qytetarëve karshi EULEX-it pësoi anim negativ me

¹ Faqja e internetit e EULEX-it. Shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/?id=2>.

² Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/cfsp, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. 16.2.2008.

daljen në pah të të ashtuquajturit Plani gjashtëpikësh. Ai plan ishte një lloj kompromisi ndaj Beogradit për të pranuar shtrirjen e EULEX-it në veri të Kosovës. Ky ishte një veprim që vuri në pikëpyetje sovranitetin e Kosovës. Një gjë e tillë rezultoi me kundërshtim të fuqishëm të shoqërisë civile dhe shoqërisë Kosovare në përgjithësi. Megjithatë, operacionalizimi i EULEX-it u bë vetëm pas përmendjes së këtyre gjashtë pikave në raportin e Ban Ki-Mun të nëntorit 2008. EULEX zyrtarisht u operacionalizua më 9 dhjetor 2008. Për kohëzgjatje, kjo është Dita ndërkombëtare kundër korrupsionit, dhe ende mbetet të shihet nëse kjo do të përbëjë një ironi apo jo.

Edhe pse EULEX-i ka në dispozicion fonde të konsiderueshme dhe burime njerëzore fushat në të cilën ata veprojnë kanë treguar pak progres gjatë këtij viti.

Policia

EULEX është mandatuar që të "monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë", por ushtron autoritet të kufizuar ekzekutiv. Kjo shtyllë e EULEX-it është ndarë në katër nën-shtylla që kanë mision dhe objektiva të ndryshme e që janë:

- Administrata e PK-së,
- Shtylla e Krimit në PK,
- Policia Kufitare e PK-së,
- Operativa e PK-së.

Sipas Deklaratës së Misionit të EULEX-it, synimi i përgjithshëm i projektit është të arrijë përparim të konsiderueshëm drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies në këto fusha dhe në zhvillimin dhe përfundimin e një shërbimi policor të pavarur dhe shumëetnik, duke siguruar që ky institucion nuk është i ndikuar politikisht dhe i përmbahet standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane³.

Drejtësia

Në këtë komponentë bëjnë pjesë pesë shtylla kryesore në kuadër të Misionit të EULEX-it në Kosovë.

- Ministria e Drejtësisë (përfshirë edhe Zyrën për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (ZPPMJ),
- Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në fushën penale,
- Gjyqtarët e EULEX-it në fushën civile,
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe
- Shërbimi Korrektues,

Ministria e Drejtësisë (përfshirë edhe Zyrën për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore (ZPPMJ) – Synimi i përgjithshëm i angazhimit të EULEX-it në Ministrinë e Drejtësisë (MD) është transformimi i suksesshëm i MD-së në një Ministri e cila funksionin në mënyrë të përkryer në të gjitha fushat e kompetencave të saj, e aftë

³ Informatat në vijim janë marrë nga: Qasja programatike e EULEX-it/Plani strategjik. Shiko: <http://www.eulex-kosovo.eu/alb/?id=27>.

për të kryer funksionet e saja në mënyrë profesionale, efikase të përgjegjshme dhe transparente duke demonstruar respekt për barazi dhe duke siguruar drejtësi për të gjithë, duke përforcuar institucionet e saja përbërëse, duke siguruar përputhshmëri me kornizën ligjore dhe duke siguruar ngritjen e kapaciteteve në mënyrë të mjaftueshme për të marrë përsipër përgjegjësi pa ndihmë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Qëllimi kryesor i angazhimit të EULEX-it në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është transformimi i KGJK-së në një organ vetëqeverisës gjyqësor, i cili garanton një shërbim profesional të një cilësie të lartë. KGJK-ja duhet të bëjë përparim substancial drejt një institucioni pa ndikime politike në kryerjen e funksioneve të cilat zhvillojnë dhe ruajnë një gjyqësor efikas, efektiv dhe të pavarur të Kosovës.

Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në fushën penale – Qëllimi i kësaj shtylle është që të arrihet progres i konsiderueshëm në drejtim të qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies lidhur me performancën e gjyqësorit kosovar si një gjyqësor shumëetnik, i paanshëm dhe i depolitizuar.

Gjyqtarët e EULEX-it në fushën civile – Kjo shtyllë synon që të arrihet një progres i konsiderueshëm në drejtim të qëndrueshmërisë për të siguruar gjykimin dhe mbarimin e paanshëm dhe efikase të lëndëve pronësore dhe në këtë mënyrë duke siguruar zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura gjyqësore.

Shërbimi Korrektues i Kosovës – Angazhimi i EULEX-it këtu është që të arrihet progres i konsiderueshëm drejt një sistemi të qëndrueshëm dhe të sigurt të burgosjes, i cili është në gjendje të përmbushë funksionet themelore si burgosja efikase, siguria dhe kontributi në rehabilitimin shoqëror lidhur me të drejtat e të burgosurve dhe parimet e menaxhimit të mire në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Dogana

Synimi i përgjithshëm i shtyllës së EULEX-it për Dogana është arritja e përparimit të konsiderueshëm drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies së Shërbimit Doganor të Kosovës, si dhe zhvillimi dhe përforcimi i mëtejme i saj si një Shërbim Doganor shumë-etnik, duke siguruar që ky institucion nuk është i ndikuar politikisht dhe i përmbahet standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane

Aktualisht EULEX-i merret me dy pika të shkatërruara doganore veriore që nga 19 shkurt 2008, pikat 1 dhe 31. Për Serbinë një kufi funksional që ndan atë nga Kosova dhe nga popullata kompakte serbe mbi Ibër është i vështirë të pranohet, megjithëse trajtimi i Kosovës si një hapësirë të veçantë doganore është praktikë (dhe është njohur si e tillë nga BE).

Strategjia e EULEX-it

EULEX-i ka hartuar një strategji e cila përmbanë gjashtë synime kryesore si dhe tetë objektiva

Synimet :

1. Ndhmë institucioneve të Kosovës për Sundimin e Ligjit në arritjen e përparimit drejt qëndrueshmërisë;
2. Ndhmë institucioneve të Kosovës për Sundimin e Ligjit në arritjen e përparimit drejt llogaridhënies;
3. Ndhmë në zhvillimin e institucioneve të Kosovës për Sundimin e Ligjit si organizata shumëetnike;
4. Ndhmë për të siguruar që institucionet e Kosovës të Sundimit të Ligjit nuk kanë ndërhyrje politike;
5. Ndhmë për të siguruar që institucionet e Kosovës të Sundimit Ligjit i përkrahin standardet e njohura ndërkombëtare;
6. Ndhmë për të siguruar që institucionet e Kosovës për sundimin e Ligjit i përkrahin praktikat më të mira evropiane.

Objektivat:

1. Të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës lidhur me të gjitha fushat që kanë të bëjnë me fushën më të gjerë të Sundimin e Ligjit. Të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës lidhur me të gjitha fushat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.
2. Të sigurojë mbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë.
3. Të ndihmojë për të siguruar që të gjitha shërbimet e sundimit të ligjit në Kosovë nuk kanë ndërhyrje politike.
4. Të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve financiare/ekonomike dhe krimeve të tjera serioze, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me pronën, hetohen, ndiqen penalisht, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi.
5. Të kontribuojë në përforcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në tërë procesin gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar.
6. Të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimeve financiare.
7. Të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë kosovare kundër korrupsionit dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit.
8. Të sigurojë që të gjitha aktivitetet lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore, i respektojnë standardet ndërkombëtare.

Arritjet e EULEX-it gjatë këtij viti të veprimit

Në bazë të raporteve të EULEX-it këto janë arritjet e tyre në tri fushat e veprimit.

Policia:

- Njësia e Hetimit të krimeve të luftës ka hapur 100 raste të reja gjatë vitit, kjo shifër përfshin zhvarrosjet, hetimet për persona të zhdukur, rastet kriminale dhe vlerësime e vendndodhjeve të varreve⁴.
- Policia e EULEX-it arrestoi disa persona të dyshuar për krime lufte.
- Ka kryer ushtrime të shumta të suksesshme me KFOR-in dhe PK.
- Departamenti i Forcimit të Policisë i EULEX-it (PSD) ka kryer me sukses një rishikim të rëndësishëm të PK. Ky rishikim ka formuar një pjesë të rëndësishme të vlerësimit të parë të hollësishëm në sundimin e ligjit në institucionet e Kosovës, të kryera nga Zyra e Programit e EULEX-it.
- Policia e EULEX ka ruajtur me sukses gjatë një operacioni afatgjatë të sigurisë në rindërtimin kontraverz të shtëpive në Kroin e Vitakut, me gjithë praninë e demonstruesve të dhunshëm.
- Qendra e Inteligjencës Financiare e EULEX-it ka përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar nëpërmjet nënshkrimit dhe zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) me Shqipërinë, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Slloveninë si pjesë e zhvillimit të bashkëpunimit rajonal.
- Rritja e bashkëpunimit të brendshëm përmes nënshkrimit dhe zbatimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit me Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit, Agjencinë e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve, dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës nëpërmjet marrëveshjeve me Administratën Tatimore dhe Doganat,
- Njësia e Inteligjencës Financiare ka hetuar 42 raste prej të cilave 20 i janë referuar prokurorisë me rekomandime se si të vazhdohet.
- Njësia e Krimit të Organizuar u përfshi në gjyqin e parë të rëndësishëm ku të dyshuarit u dënuan me burg për krim të organizuar të lidhur me vrasje.
- Më 22 korrik 2009, Shefi i Komponentit të Policisë ka nënshkruar letrën e transferimit të kompetencave nga Misioni i EULEX-it në Njësinë Kundër Terrorizmit të Policisë së Kosovës.
- EULEX-i ka prani të vazhdueshme të Njësive Speciale të Policisë dhe Policisë Kufitare në Portat 1 dhe 31 dhe patrulla të vazhdueshme dhe kapacitet për përgjigje të shpejtë nga Njësitë e Integruara Policore në mbarë Kosovën.

Drejtësi :

- Numri total i rasteve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it: 1014⁵.

⁴ Informatat në vijim janë nga: EULEX fleta e fakteve për policinë. 8 dhjetor 2009.

- Dyzet e pesë vendime janë dhënë nga panelet duke përfshirë gjyqtarët e EULEX-it.
- 351 dëgjime janë bërë nga gjyqtarët e EULEX-it.²⁴
- Në mes të muajit Qershor dhe Dhjetor 2009, Zyra e Personave të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (OMPF) ka kryer 84 operacione në terren, duke përfshirë 40 zhvarrosjet dhe Zyra e Ekzaminimeve Mjekësore Office (ZKP) ka realizuar 317 autopsi, 89 ekzaminime mjeko-ligjore klinike dhe ka dokumentuar 87 skena të vdekjes gjatë periudhë së njëjtë.²⁵
- Mbetjet e 80 personave të vdekur, të klasifikuar si persona të zhdukur, janë identifikuar dhe i janë dorëzuar familjeve të tyre gjatë vitit të kaluar.²⁶
- OMPF në mënyrë aktive ka marrë pjesë në hartimin e Ligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Ky ligj është miratuar kohët e fundit.²⁷
- Që nga dhjetori 2008, Njësia Korrektuese e EULEX-it ka:
 - Ndihtuar Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK) që të operojë një sistem efektiv dhe human korrektues që përputhet me praktikat më të mira Evropiane dhe të drejtat e njeriut dhe kontribuon për sundimin e ligjit.
 - Ngritur nivelin e sigurisë publike, duke ndihmuar në 1137 përcjellje të burgosurve,
 - 700 përcjellje MMA. (Bashkë me SHKK)
 - 354 përcjellje të pavarura.
- Përmes donatorëve ka furnizuar Shërbimin e Korrektimit të Kosovës me 2 makinat me rreze X dhe pajisje të tjera në përpjekje kundër kontrabandës dhe kontrabandës së mallrave të paligjshme në burgun e Dubravës.

Doganat :

- EULEX ka rithemeluar disa pika të kontrollit doganor (regjistrimin e mallrave komerciale) në pikat doganore në veri. Kjo tregoi një përmirësim të dukshëm në mbledhjen e të ardhurave dhe një rënie të konsiderueshme të kontrabandës së naftës⁶.
- Përveç kësaj, nga 20 maj 2009 të EULEX-it filloi të fotokopjojë ID (letër njoftimet) e shoferëve të automjeteve në hyrje komerciale dhe të dokumenteve shoqëruese komerciale për ngarkesat. Këto masa të rritura administrative kanë për qëllim luftimin e kontrabandës.
- Prej që EULEX-i ka qenë i pranishëm në pikat 1 dhe 31 kontrabanda është ulur me rreth 60%.
- Dyzet milion euro janë shpëtuar duke luftuar kontrabandën.
- Kontributi drejt inkasimit doganor të përgjithshëm nga prania e EULEX-it Doganor në Pikat 1 dhe 31.

⁵ Informatat në vijim janë nga: EULEX fleta e fakteve për drejtësinë. 8 dhjetor 2009.

⁶ Informatat në vijim janë nga: EULEX fleta e fakteve për drejtësinë. 8 dhjetor 2009.

- Më 4 janar 2010, në dogana do të jenë 60 ekspertë ndërkombëtarë të punës që do të punojnë për personelin e EULEX-it.
- Skuadrat fleksibile doganore anti-kontrabandë të Kosovës (FAST) kanë identifikuar 450 vepra dhe kanë konfiskuar mallra, në vlerë prej 405.122 euro deri në dhjetor 2009.

Qytetarët dhe EULEX-i

EULEX filloi misionin në Kosovë në shkurt të vitit 2008. Andaj pyetja për kënaqshmërinë me punën e EULEX-it u shtrua në muajin maj të vitit 2008 në hulumtimet për Raportet e paralajmërimit të hershëm të UNDP-së⁷. Kjo periudhë ishte një periudhë kur misionet e Unionit European në Kosovë nuk kishin të qartë ndarjet e fushave ku do të vepronin dhe UNMIK-u ishte ende në skenë. Këto fakte ndikuan që niveli i kënaqshmërisë për punën e EULEX-it në fillim të vendosjes së tij të jetë vetëm 13% që është një përqindje shumë e ulët.

Kënaqshmëria me punën e EULEX-it vazhdoi të rritet edhe në korrik 2008 arriti 23%, po ashtu edhe në muajin dhjetor të vitit 2008 ishte 24%. Kjo rritje ndoshta nuk arsyetohet me punën e madhe që ka bërë EULEX-i, por më shumë mund të jetë nga ndjenja e optimizmit e cila i përfshiu shqiptarët që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu faktor që ka mundur të ndikojë është edhe pakënaqësia që u krijua në Kosovë me misionin e UNMIK-ut. Kjo periudhë ishte kur kompetencat po transferoheshin nga UNMIK tek EULEX, dhe natyrisht që kjo ka ndikuar që EULEX-i të shihej nga një kënd më optimist nga të anketuarit.

Periudha e dhjetorit 2008 deri në muajin prill 2009 u karakterizua me konfuzitet dhe pakënaqësi të madhe për EULEX-in nga ana e qytetarëve të Kosovës dhe Qeverisë për shkak të gjashtë (6) pikave të Ban Ki Moon. Megjithatë, niveli i kënaqësisë me punën e EULEX-it vazhdoi të rritet deri në gusht të vitit 2009 ku ajo arrin deri në 55%. Kjo që është edhe pika më e lartë e satisfaksionit që nga fillimi i misionit EULEX në Kosovë.

Ky trend i ngritjes graduale të përqindjes së kënaqshmërinë me punën e EULEX-it ndryshoi pas muajit gusht 2009. Në muajin nëntor të vitit 2009, niveli i satisfaksionit me punën e EULEX-it ra për 15 shkallë duke rënë kështu në 40%.

Arsye shumë e fortë për rënien e kënaqshmërisë me punën e EULEX-it në këtë kohë është nënshkrimi i Protokollit për bashkëpunim policor me Serbinë në shtator. Pikërisht kjo ishte arsyeja më e madhe pse qytetarët e Kosovës nuk ishin të kënaqur më punën e EULEX-it. Ky protokoll u nënshkrua pa miratimin e Qeverisë së Kosovës, dhe ky fakt i shtyri një numër të madh njerëzish të mendojnë së para këtij misioni edhe institucionet e Kosovës janë shumë inferiore. Kjo ndikoi tek mënyra se si perceptohet ky mision nga qytetarët në Kosovë.

Arsye tjetër pse qytetarët e Kosovës filluan ta shikojnë me skepticizëm punën e EULEX-it në Kosovë është ndjenja se EULEX-i dukej si një vazhdim i UNMIK-ut. Shumë njerëz mendojnë se vetëm emërtimi i dallon këto dy misione. Arsye tjera për këtë ndryshim të trendit janë edhe çështjet ende të pazgjidhura në sektorin e gjyqësisë, e mbi të gjitha situata politike që u krijua në Mitrovicën e veriut.⁸


Kjo periudhë është koha kur fillon të vërehet zhgënjimi i parë pas pritjeve të krijuara lidhje me EULEX-in. Përderisa qytetarët kanë filluar të humbasin besimin në EULEX-in, zyrtarë të lartë të tij kanë bërë deklaratata publike duke

⁷ Shih Raportet e paralajmërimit të hershem tek www.kosovo.undp.org.

⁸ Takime me liderë të shoqërisë civile dhe analistë, 20 dhe 21 Dhjetor 2010.

premtuar rezultate në të ardhmen. Kjo ka çuar përsëri në rritjen e pritshmërive për EULEX-in, të cilat pritshmëri janë të destinuara të zhgënjehen sipas të gjitha gjasave nëse EULEX vazhdon me të njejtin ritëm të punës.

Grafiku 1. Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e EULEX-



Dështimet kryesore të EULEX-it gjatë këtij viti

EULEX-i gjatë punës një vjeçare ka treguar disa dështime. Bazuar në qëllimet për të cilat EULEX ka ardhur në Kosovë, mund të themi se në rastin më të mirë ka realizim vetëm të pjesshëm të tyre. Qysh në fillim të vendosjes së EULEX-it në Kosovë ka pasur probleme. Ato kanë ardhur kryesisht nga mungesa e unitetit brenda Komunitetit Ndërkombëtar dhe BE-së lidhje me njohjen e Kosovës dhe kompetencat e EULEX-it. Si pasojë kjo shkaktoi një lloj lufte për pushtet së pari në mes të misionëve ndërkombëtare në Kosovë e më pas edhe mes EULEX-it dhe Qeverisë së Kosovës.

Plani gjashtëpikësh i Ban Ki Moon

Këshilli i Sigurimit i OKB-së i dha mbështetjen EULEX-it më 26 nëntor 2008, përmes një plani që kompletonte rikonfigurimin e UNMIK-ut dhe hapte rrugën për vendosjen e EULEX-it në Kosovë. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-Moon përfshinte edhe të ashtuquajturin Planin gjashtëpikësh që autorizon misionin EULEX të vendoset nëpër tërë territorin e Kosovës. Në të njëjtën kohë ky plan nëse do të realizohej i jepte Serbisë pushtet të mëtutjeshëm politik në zonat serbe në Kosovë. Udhëheqësia e Kosovës patën kundërshtuar planin, për arsye se ai do të dobësonte autoritetin e institucioneve të Kosovës.⁹ Të gjithë të udhëheqësit e Kosovës, partitë politike, shoqëria civile, grupet e ekspertëve, shoqatat kulturore, të veteranëve të luftës dhe institucionet akademike patën dalur kundër planit gjashtëpikësh me argumentin se ai shkel sovranitetin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ky plan llogaritet si dështim ngaqë nuk pati pëlqyeshmëri aspak nga qytetarët e Kosovës, sidomos nga institucionet e Kosovës të cilat e shihnin këtë plan si shkelje të drejtpërdrejtë të kushtetutës. Misioni i EULEX nga qytetarët e Kosovës u pa si misioni i UNMIK, kjo për arsye se Kosova edhe pse ishte e pavarur ende sepse fuqia politike e EULEX do të cungonte lirinë politike në Kosovë. Dhe pikërisht plani gjashtë pikësh u pa si pengesë e shtrirjes së autoritetit të institucioneve të Kosovës në të gjithë territorin e Kosovës¹⁰. Ishte ky raport i Z. Ki-Moon i cili në të njëjtën kohë mundësoi operacionalizimin e EULEX-it me 9 dhjetor 2009 dhe e vendosi EULEX-in në sy të keq të kosovarëve.

Protokolli për bashkëpunim policor me Serbinë

Protokolli parasheh bashkëpunimin ndërmjet policisë së EULEX-it në Kosovë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në Serbi në fushat që lidhen me hetimin e krimit të organizuar dhe aktivitete tjera ilegale si dhe shkëmbimin e informatave mes palëve. Sipas EULEX-it, aranzhimet për bashkëpunim policor me Beogradin,

⁹ Foniqi-Kabashi, Blerta. SE Times. Këshilli i Sigurimit i OKB-së aprovon planin gjashtëpikësh të Ban-it. 27/11/2008. Shih: http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/11/27/feature-02 (Kontrolluar së fundi më 24/12/2009).

¹⁰ New Kosova Report, Kosova e bashkuar kundër planit gjashtëpikësh. 15 nëntor 2008. Shih: <http://www.newkosovareport.com/200811151406/Politics/All-Kosovo-up-in-arms-against-Six-Point-plan.html> (Kontrolluar së fundi më 24/12/2009)

të mbështetura nga 27 vendet anëtare të BE-së, janë të natyrës teknike dhe si të tilla do të jenë në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës¹¹.

Pavarësisht atyre që u thanë nga EULEX, ky protokoll u nënshkrua pa pëlqimin e institucioneve të Kosovës. Dhe, përmes këtij veprimi u shkel e drejta e institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës për të vendosur. Nënshkrimi i këtij protokollit nuk ka çuar drejt rezultateve domethënëse në punën e EULEX-it. Ndërsa, në anën tjetër ky protokoll ka krijuar konflikt mes EULEX-it dhe shoqërisë kosovare.

Rasti Bllaca

Rasti Bllaca ka bërë bujë më së shumti në mediat e Kosovës, përveç kësaj ky rast tronditi edhe qytetarët e Kosovës. Komponentet e gjyqësisë dhe policisë të EULEX-it kanë dështuar që të merren me këtë rast në kohën e duhur. Në këtë rast, EULEX kishte dështuar të bëjë çfarëdo arrestimi edhe pse sipas dëshmime kishte qenë në dijeni për akuzat e dhe deklaratimet e z. Nazim Bllaca lidhje me pjesëmarrjen e tij dhe tjerëve në vepra kriminale.

Ka mundësi që z. Bllaca të jetë shtyrë të dalë në media për ti bërë deklaratat e tij për shkak të mungesës së veprimit nga zyrtarët e EULEX-it. Kjo siç duket ka ndodhur si pasojë e moskoordinimit mes komponentëve të ndryshëm të EULEX-it.¹² Pavarësisht motiveve, dalja publike e z. Bllaca me deklaratat e tij e ka vënë EULEX-in në një pozitë shumë të vështirë. Mosefikasiteti i EULEX-it u dëshmuar edhe me ngurrimin për ta arrestuar menjëherë z. Bllaca pas deklaratave të tij. Me një fjalë, ky rast është shëndrruar në pikën kritike për misionin e EULEX-it. Nëse EULEX është i interesuar ta shpëtojë reputacionin e tij dhe të mbajë shpresat për punë të efektshme duhet të merret me këtë rast brenda një kohe të arsyeshme.

Mosfunksionimi i gjyqësorit

Gjyqësori në Mitrovicën e veriut ende nuk është funksional funksional. EULEX-i ka përgjegjësi të plotë për gjykatën në Mitrovicën e veriut. Mirëpo rifillimi i punës me kapacitet të plotë është vështirësuar edhe nga kompetencat e perziera të UNMIK-ut dhe EULEX-it. Tash për tash vetëm prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtar punojnë në këtë gjykatë.

Ndërsa, EULEX-i mban një kontigjent policësh që nuk kanë shumë punë, numri i prokurorëve dhe gjykatësve është i vogël. Kjo është brengosëse kur kihet parasysh se numri i lëndëve të pashqyrtuara është shumë i madh.

Pikat doganore 1 dhe 31

Pika 1 dhe 31 janë pika kufitare të kontrolluara nga EULEX-i megjithatë këto dy pika vazhdojnë të jenë një kanal i fuqishëm i kontrabandës në mungesë të Policisë kufitare të Kosovës dhe teknikes se nevojshme për zbulimin e mallit ilegal. Ato pika ende nuk janë funksionalizuar plotësisht. Vetëm orientimi i

¹¹ BBC Shqip, Nënshkruhet protokollit EULEX-Serbi. 12 shtator 2009 Shih: http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2009/09/090912_prishtina.shtml (Kontrolluar së fundi më 26/12/2009)

¹² Takim me zyrtar të qeverisë së Kosovës, 26 Dhjetor 2009.

mallrave nuk është i mjaftueshëm dhe po ashtu, cilësia e kontrollit duhet të rritet. Zyrtarët e Doganave të EULEX-it janë të vetëm në shërbim në pikat 1 dhe 31.¹³

Mospërputhja e strategjive

Ndërkohë, praktika ka dëshmuar se ka vetëm përrputhje të pjesshme të strategjive të EULEX-it dhe qeverisë apo injorim të strategjive ministrore nga EULEX-i. Edhe pse EULEX-i është përgjegjës për dy pika kufitare në Mitrovicën e veriut ai po ashtu luan një role tejet aktiv ne pjesë tjera të kufirit të Kosovës. Ekziston një "Strategji Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit" por ende nuk janë harmonizuar veprimet e PK me realitetin aktual pas shpalljes së pavarësisë. Ndërsa institucionet e PK dhe EULEX-i veprojnë të pavarura prej njëra-tjetrës sa i përket planit të punës¹⁴.

Struktura aktuale organizative e Policisë Kufitare nuk garanton menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike. Kjo strukturë nuk i plotëson as kushtet minimale për të funksionuar dhe për t i mbuluar nevojat dhe detyrat e përditshme. Struktura në fjalë është planifikuar për kohën kur shumica e departamenteve, regjioneve dhe stacioneve të PK-së kanë qenë të paformuara dhe të pa transformuara (ende nën Komandën e UNMIK-ut)¹⁵.

Moskoordinimi

Një Bord për sundimin e ligjit është themeluar para një viti dhe përbëhet nga institucionet kosovare dhe EULEX-it. Mirëpo ky bord edhe pse takohet nuk funksionon si duhet. Deri më tash ky bord nuk ka nxjerrë asnjë dokument që do të listonte caqet që duhen arrirë brenda mandatit të EULEX-it. Edhe pse ky bord nuk ka fuqi vendimmarrëse, ai do të mund të përpilonte një udhërrëfyes për institucionet vendore dhe EULEX-in që tregon se çfarë duhet të bëhet konkretisht dhe cilat caqe duhet të arrihen për të përmirësuar sundimin e ligjit në Kosovë.

Një problem tjetër i rëndësishëm është mungesa e koordinimit mes komponentëve të ndryshëm brenda vetë EULEX-it. Siç duket, aty ekziston një mentalitet i 'ndarjes së pushteteve' që i shtynë komponentët e ndryshëm të mendojnë se nuk janë të obliguar të bashkëpunojnë apo ndajnë informata me komponentët tjerë. Kjo mungesë e koordinimit dhe ky mentalitet ka çuar drejt humbjes së sensit të misionit. Kjo ka ndikuar në mosefikasitetin e EULEX-it siç është parë në mënyrë flagrante te rasti Bllaca. Nëse EULEX-i është i interesuar t'i arrijë objektivat e tij, duhet të karakterizohet nga një sens i fortë i misionit dhe të përmirësojë dukshëm koordinimin e brendshëm.

Mospërkushtimi ndaj misionit

Siç duket EULEX-i është duke vuajtur nga fakti se fuqitë kryesore të BE-së nuk pajtohen gjithmonë rreth EULEX-it. Rivaliteti i përgjithshëm mes të mëdhënjëve në Bruksel nuk po i bën mirë misionit në Kosovë. Është vështirë të paramendohet se EULEX-i mund t'i arrijë objektivat e tij nëse mbështetësit e tij nuk janë në

¹³ Takim me zyrtar të qeverisë së Kosovës, 26 Dhjetor 2009.

¹⁴ Takim me zyrtar të qeverisë së Kosovës, 20 Dhjetor 2009.

¹⁵ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Për Menaxhimin e Integruar të Kufirit,MPB prill 2009.
www.mpbks.org.

pajtueshmëri me njëri tjetrin sa i përket rëndësisë, rolit dhe qëllimit të tij në Kosovë.

Shumë me rëndësi është edhe ajo se si e sheh veten EULEX-i. Siç duket ka një mungesë të sensit të rëndësisë që ka ky mision për Kosovën. Pozita e shefit të shtyllës së policisë, ka mbetur e paplotësuar për rreth dy muaj dhe vazhdon të mbetet e tillë. Mungesa e ndjenjës së urgjencës për plotësimin e një posti të tillë tregon për një qasje jo të qëlluar ndaj përgjegjësive nga vetë misioni. Diçka tjetër që tregon përkushtimin ndaj misionit është ajo se a janë personeli i lartë të sekonduar nga qeveritë e shteteve apo të kontraktuar. Shefi i shtyllës së doganave në EULEX, një post shumë i rëndësishëm, është i kontraktuar e jo i sekonduar (dërguar) nga ndonjë shtet i BE-së. Dedikimi i stafit të kontraktuar ndaj objektivave të misionit, nëse bëhet fjalë për pozita të larta, mund të vihet në pyetje.

Një problem serioz për EULEX-in është mungesa e dukshme e mbështetjes politike nga Brukseli. Është e çuditshme se BE nuk ka treguar ndonjë interes të veçantë në misionin e saj më të madh civil deri më tash. Ky mosinteresim vërehet edhe te alokimi i fondeve të Instrumentit për Asistencë Para-anëtarësimit (IPA). Alokimi i fundit i fondeve të IPA-s kishte injoruar Ministrinë e Drejtësisë, ministri kjo kyçe për suksesin e EULEX-it, duke e lënë atë pa farë asistence.¹⁶

Është brengosës fakti se as Përfaqësuesi Special i BE-së (PSBE, angl. EUSR), që është i mandatuar të ofrojë udhëheqje politike për EULEX-in, nuk ka ofruar mbështetjen politike të duhur për këtë mision. Instalimi i një Përfaqësuesi Special të BE-së (PSBE) i cili në të njëjtën kohë do të jetë kreu i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), e cila u ngarkua ta ndihmojë Kosovën në procesin e integritimit në BE dhe zbatimin e dispozitave të Planit të Ahtisaarit mund të kishte qenë moment shpresëdhënës. Duke marrë parasysh që detyra kryesore e këtij organi është koordinimi i organizatave ndërkombëtare në Kosovë, duket qartë që ky organ ka dështuar në qëllimet e tij, nga vetë fakti që në Kosovë është krijuar konfuzitet dhe pështjellim në ndarjen e kompetencave të këtyre organizatave në Kosovë¹⁷.

Një fushë shumë e rëndësishme ku do të mund të ndikonte udhëheqja politike e EUSR është reforma e gjyqësorit. Nuk është e imagjinueshme se misioni i EULEX-it mund të ketë sukses pa reforma në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ndërsa, deri tash nuk kemi parë ndonjë presion për të shtyrë këtë reformë e cila është shumë e vonuar. Gjendja aktuale e gjyqësorit është e mjerë. Me gjyqtarë shumë të moshuar dhe me një bagazh të rëndë nga sistemi komunist gjyqësori është dëshmuar se është i paaftë t'u bëjë ballë sfidave në Kosovën e pasluftës. Ngurtësimi i një sistemi të cytjeve perverse ka çuar drejt një bllokade. Gjyqësori kosovar ka nevojë për reformë të rrënjësishme që krijojnë një sistem cytjesh për performancë efikase në zgjidhjen e rasteve dhe sjellë gjak të ri.

¹⁶ Takim me zyrtar të qeverisë së Kosovës, 16 Dhjetor 2009.

¹⁷ Dzhic, Vedran dhe Helmut Kramer Kosova pas pavarësisë, July 2009.

Rekomandime

Për Qeverinë dhe EULEX-in

Të shfrytëzohet më mirë Bordi i Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit duke shërbyer si forum ku krijohet një listë e çaqeve që duhet të arrihen brenda një viti.

Të harmonizohen strategjitë mes EULEX-it dhe ministrive që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.

Të përmirësohet koordinimi i brendshëm i EULEX-it.

T'i kushtohet vëmendje të veçantë reformës së gjyqësorit meqenëse është hallka kryesore e sundimit të ligjit.

Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për funksionalizimin e plotë të gjykatës në veri të Mitrovicës brenda tre muajve.

Të funksionalizohen plotësisht pikat doganore 1 dhe 31 sa më shpejtë që është e mundur.

Të bëhet transparent brenda mundësive shqyrtimi i rastit Bllaca.

Të rritet sensi i misionit brenda stafit të EULEX-it për të parandalur shëndrrimin në një mision që i shërben vetvetes.

Të identifikohen fushat ku EULEX-i mund të ndihmojë në plotësimin e kriterëve për liberalizim të vizave.

Për BE-në dhe PSBE-në

Të krijohet presion mbi udhëheqësinë kosovare për reformat e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit me fokus te gjyqësori.

Të krijohet presion mbi Beogradin për të mos penguar funksionalizimin e pikave doganore 1 dhe 31 dhe gjykatës në Mitrovicë veriore.

Të forcohet udhëheqësia që i ofrohet misionëve të BE-së në Kosovë.

Të shfrytëzohen fuqitë e reja të dala nga traktati i Lisbonës për Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për të lehtësuar funksionimin e misionëve të BE-së në Kosovë.

Të forcohet udhëheqësia politike e PSBE-së, dhe ku është e nevojshme të bëhet presion për tu krijuar vullneti politik për reforma.

Rreth IPOL-it

Instituti Ballkanik i Politikave është një institut i pavarur dhe jo-fitimprurës që synon të inicojë dhe thellojë debatin rreth politikave publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Me seli në Prishtinë, Kosovë, Instituti Ballkanik i Politikave punon për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë nëpërmjet bërjes së politikave pragmatike që punojnë për të mirën e qytetarëve.

Misioni ynë është forcimi i kuptimit e ndikimit që kanë politikat publike në mesin e qytetarëve të Kosovës, shoqërisë civile grupeve avokuese dhe institucioneve vendimmarrëse. Ne e bëjmë këtë duke identifikuar çështjet më thelbësore, duke bërë hulumtime, duke krijuar zgjidhje dhe strategji inovative që kanë për qëllim të kuptuarit dhe zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe politikave publike.

Instituti Ballkanik i Politikave – IPOL ka për qëllim që të ofrojë analiza të shëndosha dhe profesionale për vendimmarrësit; të ofrojë metoda efektive për avokim për qytetarët dhe grupet e interesit duke i mbështetur ata në procesin e vendimmarrjes.

Objektivat e Institutit Ballkanik për Politika janë: Të sigurojë që proceset e integriteteve evropiane, decentralizimit dhe reformës së tregut të jenë shfrytëzuar për forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje; për ti fuqizuar komunitetet lokale për adresimin e sfidave të tyre në mënyrë të qëndrueshme; për të sjellur mirëqenie për qytetarët; për të rritur llogaridhënien e qeverisë dhe për të siguruar një ambient më të sigurtë dhe më të shëndetshëm.

Instituti Ballkanik i Politikave bashkëpunon ngushtë me partnerë të shoqërisë civile, qeverisë dhe akademikë duke shfrytëzuar një qasje gjithëpërfshirëse drejt arritjes së qëllimeve; në mënyrë pro-aktive angazhohet me akterët kyç të hartuesve të politikave publike; në vazhdimësi zhvillon studime duke ofruar përgjigje të përshtatshme për çështje me rëndësi, bënë monitorimin e zbatimit të politikave publike duke analizuar edhe pasojat që krijojnë ato.

Fokusi i Institutit Ballkanik të Politikave përfshinë qeverisjen, zhvillimin e qëndrueshëm, çështjet sociale, shëndetësinë, arsimin, zhvillimin ekonomik, qeverisjen lokale, marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare, sundimin e ligjit, transparencën dhe shoqërinë civile.

Institutit Ballkanik i Politikave punëson staf të përhershëm dhe ekspertë hulumtues të fushave të ndryshme, si dhe praktikantë. Stafi i Institutit dhe ekspertët janë individë të motivuar dhe dinamikë, të përkushtuar për Kosovën dhe rajonin e Evropës juglindore.